



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Ministarstvo za kulturu, omladinu i sport-
Ministry of Culture, Youth and Sports

Departamenti i Kulturës/Departman za kulturu/Department of Culture

Në bazë të nenit 145 pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1, paragrafi 1.3 (ç) të Rregullorës 2001/19, nenit 15 pika 2 të Ligjit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin, Nr. 02/L-51, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Valton Beqiri, më 01.12.2009, nxjerr këtë:

Rregullore

PËR ÇMIMIN KOMBËTAR LETRAR PËR VEPËR JETËSORE “AZEM SHKRELI” DHE PËR ÇMIMET VJETORE PËR LETËRSI

Neni 1.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit jep këto çmime në fushën e letërsisë:

1. Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli”,
2. Çmimet letrare për librat më të mirë të botuara brenda vitit kalendarik:
 - 1.1. Për librin më të mirë në prozë;
 - 1.2. Për librin më të mirë me poezi;
 - 1.3. Për librin më të mirë në kritikë letrare, eseistikë;
 - 1.4. Për librin më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Neni 2.

Shuma neto e çmimeve është si vijon:

1. Çmimi Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli”5.000 euro

2. Çmimet vjetore për letërsi:

2.1. Për librin më të mirë në prozë.....2.500 euro

2.2. Për librin më të mirë me poezi.....2.500 euro

2.3. Për librin më të mirë në kritikë, eseistikë.....2.500 euro

2.4. Për librin më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.....2.500 euro

3. Mjetet për dhënien e çmimeve i siguron Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3.

Çmimet vjetore për letërsi jepen për veprat më të mira të botuara brenda vitit kalendarik në zhanret e përmendura në nenin 1.

Neni 4.

Çmimi Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli” i jepet shkrimtarit që është shtetas i Republikës së Kosovës.

Neni 5.

1. Konkurrimi për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli” bëhet përmes nominimit nga këto institucione:

1.1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës,

1.2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

1.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë,

1.4. Instituti Albanologjik i Prishtinës,

1.5. Biblioteka Kombëtare e Kosovës,

1.6. Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës- Dega e Letërsisë dhe e Gjuhës Shqipe.

2. Shtëpitë botuese:

- 2.1. Redaksitë e gazetave dhe revistave letrare-kulturore,
- 2.2. Asociacionet e shkrimtarëve që veprojnë brenda territorit të Kosovës,
- 2.3. OJQ-të që merren me veprimtari kulturore.
- 2.4. Propozime mund të bëhen edhe nga personalitetet me reputacion publik.

Neni 6.

Ftesa për konkurrim për çmimet letrare të MKRS-së bëhet përmes shpalljes publike që botohet në mediet e shkruara dhe përmes informatës që shërbimi për çmime ia drejton institucioneve të parapara në nenin 5.

Neni 7.

Konkurrimi për çmimet vjetore bëhet individualisht nga vetë krijuesit dhe përkthyesit, sikundër edhe përmes propozimeve të parapara në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 8.

Propozimet e subjekteve të përmendura më sipër paraqiten në MKRS, përmes Drejtorit të Departamentit të Kulturës - shërbimit për çmime.

Neni 9.

Shpallja publike për konkurrim bëhet gjatë muajit dhjetor dhe mbyllet më 5 janar të vitit pasues.

Neni 10.

Me rastin e konkurimit për çmimet vjetore, subjekti që konkurren është i detyruar t'i dorëzojë arkivit për çmimet letrare edhe 6 (gjashtë) kopje të librit konkurrues.

Neni 11.

1. Për vlerësimin dhe ndarjen e çmimeve Ministri formon jurinë profesionale prej 5 antarëve.
2. Anëtarë të jurisë duhet të jenë krijues letrarë me reputacion dhe njohës të procesit aktual letrar.
3. Kompensimi për punën e jurisë bëhet sipas një marrëveshjeje të veçantë.

Neni 12.

1. Çmimin e dorëzon Ministri në një ceremoni solemne më 17 Shkurt, Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Në solemnitetin e dorëzimit të çmimeve ftohen të marrin pjesë personalitetet prominente të artit, kulturës dhe shkencës në Kosovë.
2. Çmimi i dorëzohet vetë laureatit, por nëse çmimi jepet post-mortum ai i dorëzohet familiarëve të tij.
3. Laureatit që i dorëzohet çmimi i jepet edhe certifikata me fotokopjen e vendimit.
4. Certifikata përmban emrin e personit të cilit i jepet çmimi, motivacionin për çmim, numrin e vendimit të nënshkruar nga Ministri dhe vuloset me vulën e Ministrit.

Neni 13.

Për përcjelljen e zbatimit të kësaj rregulloreje ngarkohet Drejtori i Departamentit të Kulturës së MKRS-së.

Neni 14.

Rregullorja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja e mëparshme e aprovuar më 22.11.2005.

Prishtinë,
01.12.2009



Ministri i MKRS-së,
Valton Beqiri